

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA TREGTARE "EUROELEKTRA" SHPK
NIPTI : L01808013Q
ADRESA : Njesia administrative Vaqarr, Tirane - Rruga Prush 1041, Vaqarr.

TIRANE

VENDIM
NR.4. DATE 21/09/2016
I ASAMBLESE SE ORTAKEVE
TE SHOQERISE EUROELEKTRA SH.P.K
TIRANE

Sot me date 21/09/2016 ,në selinë e Shoqërisë "EUROELEKTRA" SH.P.K Tiranë u zhvillua mbledhja e ASAMBLESE SE ORTAKEVE të Shoqërisë , rendi i ditës të së cilës është , shqyrtimi i raportit të paraqitur nga Eksperti Kontabël i Regjistruar për rritjen e Kapitalit të shoqërisë nëpërmjet " Fitimit të pashpërndarë" dhe "Fitimit të Ushtrimit 2015" që janë gjendje sipas Bilancit Kontabël më datë 31.12.2015. dhe në përfundim ASAMBLEA e SHOQËRISË "EUROELEKTRA" SH.P.K Tiranë ,

VENDOSI:

- Miratimin e raportit të Ekspertit Kontabël të Rregjistruar **z.Bujar RAMI**
- Zmadhimin e Kapitalit Aksionar të shoqërisë sipas mënyrës së përcaktuar në raportin e Ekspertit Kontabël të Regjistruar.
- Zmadhimin e Kapitalit Aksionar të shoqërisë "EUROELEKTRA" SHPK nga **4.500.000 lekë**, në **10.886.172 lekë**.
- Nr i kuotave pas këtij zmadhimi nuk do të ndryshojë ,pra ishin **2** kuota dhe do të ngelen **2** kuota .
- Vlera nominale kuotës në para do të rritet sipas mënyrës së paraqitur në Raportin e Ekspertit Kontabël.
- Përqindja e pjesëmarrjes së Ortakeve , pas rritjes së Kapitalit nuk do të ndryshojë.
- Depozitimim e ketij vendimi pranë Q.K.R –së Tiranë.
- Ngarkohet **zj Xhulia Rami** të ndjekë procedurat ligjore për depozitimim e këtij vendimi pranë QKR-s Tirane.



ORTAKET

(Elton Çekrezi) (Anduel Çekrezi)

Elton Çekrezi *Anduel Çekrezi*

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA TREGTARE "EUROELEKTRA" SHPK
NIPTI : L01808013Q
ADRESA : Njesia administrative Vaqarr, Tirane - Rruga Prush 1041, Vaqarr.

TIRANE

VENDIM
NR.3, DATE, 09/09/2016
I ASDAMBLESE SE ORTAKEVE TE
TE SHOQERISE "EUROELEKTRA" SH.P.K
TIRANE

Sot me datë 09/09/2016, në Selinë e Shoqërisë "EUROELEKTRA" SH.P.K Tiranë, u zhvillua mbledhja e ORTAKEVE të SHOQERISE për emërimin e Ekspertit Kontabël të Regjistruar, për hartimin e raportit për zmadhim kapitali nëpërmjet "Fitimit të pashpërndarë" dhe "Fitimit të Ushtrimit 2015, që janë gjendje në Bilancin kontabël datë 31.12.2015, dhe në përfundim ASAMBLEA:



VENDOSI:

- Caktimin e z. **Bujar RAMI**, anëtarë i I.E.K.A, me profesion Ekspert Kontabël i Regjistruar, me licensë Nr. 90. datë 10.01.2001, për vlerësimin e zmadhimit të Kapitalit Aksionar nëpërmjet, "Fitimit të pashpërndarë" dhe "Fitimit të Ushtrimit 2015, që janë gjendje sipas Bilancit Kontabël më datë 31.12.2015.
- Depozitimin e këtij vendimi në Q.K.R
- Ngarkohet zj **Xhulia Rami** të ndjekë procedurat ligjore për depozitimin e këtij vendimi pranë QKR –së Tiranë.

ORTAKET

(**Elton Çekrezi**)

(**Anduel Çekrezi**)

SHOQËRISË "EUROELEKTRA " SH.P.K

TIRANË

NIPTI 01808013Q

**RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR PËR
ZMADHIM KAPITALI**

EKSPERT KONTABËL I REGJISTRUAR


(BUJAR RAMI)

LIÇENCA NR. 90 DT. 10.01.2001, NIPT L21501047E

ADRESA : RRUGA "GJIN BUE SHPATA" TIRANË

E-MAIL: bujar.rami@live.com, cel: 0686064118

SHTATOR 2016



**ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE
TE SHOQERISE "EUROELEKTRA" SH.P.K TIRANE
SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**RAPORT I EKSPERTIT KONTABEL TE REGJISTRUAR
PER ZMADHIM KAPITALI TE SHOQERISE
"EUROELEKTRA" SH.P.K TIRANE**

Me cilësinë e Ekspertit Kontabël të Regjistruar i emëruar, nga Asamblea e Ortakëve të Shoqërisë "EUROELEKTRA" SH.P.K Tiranë ,me **vendimin Nr.3** datë **09.09.2016**, për hartimin e raportit mbi zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "EUROELEKTRA" SH.P.K Tiranë , si dhe ne zbatim të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 , " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"(I ndryshuar) neni 145,pika 1, Neni 168,pika 1,Neni 169,pika 1 , neni 177,pika 1 dhe 2, neni 178 pika 1 dhe 2, ju paraqes raportin tim sa më poshtë vijon :

Shoqëria "EUROELEKTRA" SH.P.K Tiranë , me NIPT L01808013Q L dhe me seli në Tiranë , është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me kapital aksionar **4.500.000** (katërmilion e pesëqintë mijë) lekë , me ortakë z.**Anduel Çekrezi** dhe z **Elton Çekrezi** , te cilit zotërojnë pëkatësisht 40% dhe 60% z të kapitalit aksionar kapital i cili është në masën **4.500.000** lekë.
Përfaqësues ligjor i shoqërisë është z. **Elton Çekrezi**.


Në zbatim të misionit të ngarkuar nga Asamblea e Ortakëve të Shoqërisë me vendimin e cituar më lartë , u shqyrtuan dhe u kryen verifikimet e nevojshme konform rregullave të profesionit dhe dispozitave ligjore ne fuqi.

Sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve të kësaj Shoqërie Nr. 3 datë **09.09.2016** është vendosur rritja e kapitalit aksionar në masën **6.386.172** (gjashtë milion e treqintë e tetëdhjetë e gjashtëmijë e njëqintë e shtatëdhjetë e dy)lekë , si dhe rritja e vlerës për një pjesë sipas përcaktimit të tabelës së mëposhtëme. Nr.i kuotave dhe % e pjesëmarrjes së ortakëve në kapital edhe pas këtij zmadhim kapitali nuk do të ndryshojnë .

Rritja e kapitalit do të bëhet , nga përfshirja në kapital e "Fitimit Neto të ushtrimit të vitit 2014" për vlerën **3.481.264** lekë dhe e "Fitimit Neto të vitit 2015"(pasi janë zbritur rezervat ligjore) , për vlerën **2.904.908** lekë ,fitime të cilat janë të evidentuar dhe rezultojnë gjendje në Bilancë me datë 31.12.2015.
Gjithsej rritja e kapitalit do të jetë **6.386.172** lekë.

Nga testet dhe verifikimet përkatëse që kam bërë rezulton se vlerat e "Fitimit të ushtrimit 2014" dhe e e "Fitimit Neto të ushtrimit të vitit 2015

f.1



të shoqërisë "EUROELEKTRA" SH.P.K Tiranë janë të evidentuar saktësisht dhe të paraqitura në mënyrë korrekte në bilancin kontabël të ushtrimit 2015. Për vlerësimin për rritjen e kapitalit jam mbështetur në bilancin kontabël të ushtrimit 2015, bilanc në të cilin janë evidentuar saktësisht në llogarië përkatëse vlerat respektive me anën e të cilave do të bëhet zmadhimi i kapitalit , si dhe në dokumenta të tjera të vëna në dispozicion nga ana e shoqërisë sic janë :Inventarët e pasurisë,analizat e llogarive ...etj.

Si përfundim:

A -Kapitali aksionar i shoqërisë "EUROELEKTRA" SH.P.K Tiranë ,pas këtij zmadhimi do të jetë si me poshtë vijon :

	ISHTE	BËHET
- Kapitali aksionar i regjistruar	4.500.000 lekë	10.886.172 lekë

B- Pjesët e zotëruara ,përqindja e pjesëmarrjes dhe kontribudi në kapitalin e Shoqërisë "EUROELEKTRA" SH.P.K Tiranë i Ortakëve Individ pas këtij zmadhimi do të jenë si me poshtë vijon :


1-Për Ortakun Individ Anduel Çekrezi

	ISHTE	BËHET
-Pjesët e zotëruara	1(pjesë)	1(pjesë)
-Përqindja e pjesëmarrjes	40 (%)	40 (%)
-Kontribudi në para	1.200.000 lekë	3.754.469 lekë
- Kontribudi në natyrë	600.000 lekë	600.000 lekë
<u>-Totali I kapitalit (Anduel Çekrezi)</u>	1.800.000 lekë	4.354.469 lekë

2-Për Ortakun Individ Elton Çekrezi

	ISHTE	BËHET
-Pjesët e zotëruara	1(pjesë)	1(pjesë)
-Përqindja e pjesëmarrjes	60 (%)	60 (%)
-Kontribudi në para	1.800.000 lekë	5.631.703 lekë
- Kontribudi në natyrë	900.000 lekë	900.000 lekë
<u>-Totali I kapitalit (Elton Çekrezi)</u>	2.700.000 lekë	6.531.703 lekë

f.2



Theksohet këtu se pas këtij zmadhim kapitali, përqindja e pjesëmarrjes së ortakëve në Kapital, Numëri I kuotave dhe Kapitali në natyrë nuk kanë ndryshuar, por ka ndryshuar, kontribudi në para I zotëruar nga ortakët në Kapital.

Në zbatim të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” neni 145, pika 1, neni 177, pika 1 dhe 2“, për zmadhimin e kapitalit , si dhe të vendimit përkatës të Asamblesë së Ortakëve të kësaj Shoqërie , shuma prej **10.886.172** (dhjetë milion e tetëqintë e tetëdhjetë e gjashtë mijë e njëqintë e shtatëdhjetë e dy) lekë është e argumentuar dhe e sistemuar sipas rregullave të mbajtjes së kontabilitetit financiar duke u paraqitur në postet e duhura të bilancit të reformuar të kësaj shoqërie. Llogaritë që janë prekur si rezultat i zmadhimit të kapitalit aksionar si më sipër janë : llogaria 101, 108. dhe llogaria 109.

Operacioni i zmadhimit të kapitalit të shoqërisë “ **EUROELEKTRA**” Sh.P.K Tiranë Burrel i propozuar dhe i miratuar nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, është i motivuar nga legjislacioni në fuqi dhe i justifikuar financiarisht.

Pas shqyrtimit të sipërpërmendur të dokumentave financiare e kontabël, kapitali i përcaktuar prej **10.886.172** (dhjetë milion e tetëqintë e tetëdhjetë e gjashtë mijë e njëqintë e shtatëdhjetë e dy) lekë i përgjigjet vlerës së aktivitetit neto të shoqërisë.

EKSPERTI KONTABEL I REGJISTRUAR

BUJAR RAMI



Tiranë: më 16.09.2016